

Kualifikimet e Organeve Drejtuese

Këshilli Drejtues:

Peter Lennkh	- Kryetar
Heinz Hödl	- Zëvendëskryetar
Andreas Engels	- Anëtar
Harald Kreuzmair	- Anëtar
Ferenc Berszan	- Anëtar

Curriculum vitae

Peter Lennkh

Anëtar Bordi për Biznesin me Korporatat

1. Edukimi

Universiteti i Ekonomisë, Vienë

Master në Ekonomi dhe Administrim Biznesi

2. Përvoja

2013 – deri tani	Raiffeisen Bank International AG (RBI) Anëtar Bordi për Biznesin me Korporatat
2010 – 2013	Raiffeisen Bank International AG Anëtar Bordi për Menaxhimin e Rrjetit të Bankave
2004 – 2010	Raiffeisen International Bank Holding AG Anëtar Bordi për Biznesin me Korporatat dhe Koordinimin e Rrjetit të Bankave
1999-2004	Raiffeisen Zentralbank Österreich AG Drejtor i Divizionit të Financave Tregtare dhe të Eksporteve
1998 – 1999	Raiffeisen Zentralbank Österreich AG Drejtor i Divizionit të Korporatave për Klientët Ndërkombëtarë
1997 – 1998	Raiffeisen Zentralbank Österreich AG

Menaxhimi i Bankave të rrjetit në grupin RZB: themelimi i Raiffeisen Bank Rusi dhe Raiffeisen Bank Ukrainë

1992 - 1996	Raiffeisen Bank Republika Çeke Zv. Anëtar Bordi për Kreditë, Menaxhimin e Riskut dhe Klientët Korporatë Austriakë
1990 – 1991	Creditanstalt Leasing, Vienë Drejtor i Departamentit të Financimit të Projekteve Ndërkombëtare
1988 – 1990	Raiffeisen Zentralbank Österreich AG Account Manager për Financat Ndërkombëtare

Heinz Hödl

Këshilltar i Lartë i Bordit Drejtues të Raiffeisen Bank International AG

1. Edukimi

1960	Përfundimi i shkollës së Mesme
1960 – 1963	Studime Universitare në Ekonomi dhe Administrim biznesi

2. Përvoja

2006 – deri tani	Raiffeisen Bank International AG Këshilltar i lartë i Bordit Drejtues
Që prej vitit 2000	Anëtar i Bordit Mbikëqyrës në Rusi, Poloni, Ukrainë, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumani, Sloveni, Bosnjë dhe Herzegovinë, Bjellorusi, Kosovë, Shqipëri, New York. President i Komitetit të Auditit në Shqipëri, Kosovë, Sloveni, Serbi, Rumani, Kroaci, Bullgari, Rusi, Ukrainë
2006 – 2011	Raiffeisbank Investment AG, Vienna Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës
2000 – 2006	Raiffeisen Bank International AG

	Anëtar i Bordit Drejtues
1986 – 1993	Katherin Bank AG Anëtar i Bordit Drejtues
1961 – 2003	Raiffeisen Zentralbank AG Drejtor i Divizionit Ndërkombëtar

Andreas Engels

*Drejtor i Divizionit të Menaxhimit të Riskut të Kredisë Korporatë
Raiffeisen Bank International AG*

1. Edukimi

1982 - 1987	Shkolla e Mesme Ekonomike
1995 – 1997	Studime Universitare në Ekonomi dhe Komunikim

2. Përvoja

10/2010 – deri tani	Raiffeisen Bank International AG, Vienna Divizioni i Menaxhimit të Riskut të Kredisë Korporatë Drejtues, Commercial PoA
9/2004 – 10/2010	Raiffeisen International Bank Holding AG, Vienna Manaxhim i Kredisë së Rrjetit Zv/President, Ltd. Commercial PoA
4/2000 – 8/2004	Raiffeisen Zentralbank, Vienna Manaxhimi i Kredisë së Rrjetit Zv/President, Ltd. Commercial PoA
Deri në 10/2003	Raiffeisen Zentralbank, Vienna Manaxhimi i Kredisë Ndërkombëtare Manaxher i Lartë për Rrezikun e Kredisë
1/1991 – 3/2000	Bank Austria Creditanstalt Leasing, Vienna

Menaxhim i Rrezikut të Grupit
Manaxher i Lartë për Rrezikun e Kredisë

8/1988 – 12/1990 Vereinigte Volksbanken, Baden
Përgjegjës në Departamentin e Kredisë

Mag. Harald R. Kreuzmair

Drejtor i Divizionit për Klientët Institucionalë në Raiffeisen Bank International AG

1. Edukimi

1983 - 1990 Studime në Administrim Biznesi në Universitetin e Ekonomisë dhe Biznesit të Vienës

Master në Universitetin e Ekonomisë dhe Biznesit të Vienës

2. Përvoja

1/2011 – deri tani Raiffeisen Bank International (RBI)
Drejtor i Divizionit të Klientëve Institucionalë

6/2009 – 12/2010 Raiffeisen Zentralbank, Vienna (RZB Austria)
Drejtor i Divizionit të Institucioneve Financiare dhe Shitjes së Kapitaleve të Tregjeve

1/2009 – 5/2009 Raiffeisen Zentralbank, Vienna (RZB Austria)
Drejtor i Divizionit të Menaxhimit të Ekspozimeve kundrejt Institucioneve Financiare
Zv. President

12/2006 – 12/2008 Raiffeisen Zentralbank, Vienna (RZB Austria)
Drejtor i Divizionit të Institucioneve Financiare

12/2004 – 12/2006 Raiffeisen Zentralbank, Vienna (RZB Austria)
Drejtor i Borxhit të Tregjeve të Kapitalit

6/2001 – 8/2004 Bank Austria Creditanstalt Vienna – HVB Group
Drejtor i Departamentit EEMEA Origination, Rating Advisory & Corporate Sales

3/1999 – 6/2001 Bank Austria Creditanstalt Vienna
Drejtor i Departamentit të të Ardhurave Fikse për Zhvillimin e Tregjeve Evropiane

	Zv/Menaxher i Përgjithshëm
5/1997 – 6/1999	Bank Austria Creditanstalt Vienna Group Treasury Vienna Drejtues i lartë në Departamentin e Shitjeve dhe Tregtimit të të ardhurave fikse në Evropën Qendrore dhe Lindore
10/1996 – 4/1997	Creditanstalt Vienna Drejtor i Tregtimit të të Ardhurave Fikse nga Monedha e Huaj
5/1995 – 11/1996	Creditanstalt Vienna Zv/Drejtor i Tregtimit të të Ardhurave Fikse në shilingën austriake
1/1994 – 7/1995	Oesterreichische Investmentgesellschaft (OIG) Vienna Menaxher i lartë për të Ardhurat Fikse nga Investimet e Huaja Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës
7/1991 – 12/1994	Creditanstalt Vienna Asset Management Menaxher i Portofolit të Klientëve Insitucionalë dhe Jo-Rezidentë Anëtar i Komitetit të Alokimit të Aseteve të Creditanstalt
4/1990-6/1991	Creditanstalt Vienna Trajnim 15-mujor në Creditanstalt

MSc, MBA Ferenc Berszan

Drejtor i Divizionit të Biznesit të Vogël, Bankingut Premium dhe Privat në Raiffeisen Bank International AG

1. Edukimi

1994 – 1995	Universiteti Teknik i Budapestit – SUNY Buffalo. Student doktore dhe Manaxher Projekti për Menaxhimin e Përgjithshëm të Cilësisë, projekt i sponsorizuar nga fondet e US AID.
1992 – 1994	Universiteti Teknik i Budapestit – SUNY Buffalo, Master në Administrim Biznesi
1987 – 1992	Universiteti Teknik i Budapestit Master Shkencor në Inxhinieri Elektrike

2. Përvoja

1/2010 - present	Raiffeisen Bank International (RBI) Drejtori i Divizionit të Biznesit të Vogël, Bankingut Premium dhe Privat
------------------	---

2/2005 – 12/2009	Raiffeisen Bank International (RBI)/ më përpara Raiffeisen International (RI) Drejtor i Bankingut për Konsumatorët (Zv/president i Lartë)
2004 – 2005	Budapest Bank, GE Capital Drejtor i Biznesit të Pasiguar (Anëtar i Menaxhimit të Lartë)
2001 – 2003	Hungarian Innovative Technologies Fund Budapest Zv/Drejtor
1997-1999	Budapest Bank, GE Capital Drejtor i Operacioneve

Komiteti i Kontrollit

Heinz HÖDL	- Kryetar
Johannes Kellner	- Zëvendëskryetar
Susanna Benoit	- Anëtare

Heinz Hödl

Këshilltar i Lartë i Bordit Drejtues të Raiffeisen Bank International AG

1. Edukimi

1960	Përfundimi i shkollës së Mesme
1960 – 1963	Studime Universitare në Ekonomi dhe Administrim biznesi

2. Përvoja

2006 – deri tani	Raiffeisen Bank International AG Këshilltar i lartë i Bordit Drejtues
Që prej vitit 2000	Anëtar i Bordit Mbikëqyrës në Rusi, Poloni, Ukrainë, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumani, Sloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bjellorusi, Kosovë, Shqipëri, New York. President i Komitetit të Auditit në Shqipëri, Kosovë, Sloveni, Serbi, Rumani, Kroaci, Bullgari, Rusi, Ukrainë

2006 – 2011	Raiffeisenbank Investment AG, Vienna Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës
2000 – 2006	Raiffeisen Bank International AG Anëtar i Bordit Drejtues
1986 – 1993	Katherin Bank AG Anëtar i Bordit Drejtues
1961 – 2003	Raiffeisen Zentralbank AG Drejtor i Divizionit Ndërkombëtar

Johannes Kellner

1. Edukimi:

9/2000 – 6/2004	Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Vienë Master në Financë Bankë
-----------------	---

2. Përvoja

Që prej 1/2005	Raiffeisen Bank International AG Menaxher - Departamenti i Njësive Bankare Ndërkombëtare
10/1999 – 12/2004	Raiffeisen Zentralbank, AG Shitjet e instrumenteve me të ardhura fikse, Klientët Korporatë
10/1990 – 9/1999	Raiffeisenbank Specialist për Marrëdhëniet me Klientët Individë

Susanna Benoit

1. Edukimi

1990 – 1996 Universiteti i Ekonomisë dhe Administrimit të Biznesit, Vienë
Diplomë Master

2. Përvoja

10/2011 – present Raiffeisen Bank International
Drejtoreshë Ekzekutive, Departamenti i Njësive Bankare Ndërkombëtare

7/2010 – 9/2011 Leje lindjeje

3/2006 – 6/2010 Raiffeisen International Bank Holding AG
Zv/presidente e Zyrës Rajonale

9/2004 – 2/2006 Raiffeisen International Bank Holding AG
Menaxhere e Zhvillimit të Biznesit – Kartat

3/2003 – 8/2004 Raiffeisen Zentralbank Österreich AG
Menaxhere e Zhvillimit të Biznesit – Kartat

10/1999 – 2/2003 Raiffeisen Zentralbank Österreich AG
Menaxhere Rajonale për Evropën Juglindore – Menaxhimi i Bankave të Rrjetit

1/1997 – 9/1999 Raiffeisen Zentralbank Österreich AG
Menaxhere për Marrëdhëniet me Bankat – Menaxhimi i Bankave të Rrjetit dhe
Degëve

Drejtoria/Bordi Drejtues

Christian Canacaris - Drejtori i Përgjithshëm

Z. Christian Canacaris është Drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank në Shqipëri që prej muajit tetor 2010.

Z. Canacaris është një bankier me një përvojë mjaft të gjerë. Ai ka punuar për shumë vite në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe tregjet në zhvillim në pozicionin e Anëtarit të Bordit. Z. Canacaris ka një karrierë të gjatë në fushën e Thesarit dhe Tregjet e Kapitalit.

Z. Canacaris iu bashkua Raiffeisen Bank në prill të vitit 2004 si Anëtar Bordi për Thesarin, Bankingun e Investimeve dhe Tregjet e Kapitalit. Gjatë periudhës shkurt 2010-tetor 2015 ai ka qenë gjithashtu përgjegjës për Bankingun e Korporatave në nivel bordi.

Gjatë karrierës së tij të gjatë bankare ai ka mbajtur pozicione menaxheriale në RZB Krekova Bank, Raiffeisen Bank Maribor Sloveni, në Raiffeisen Bank Rumani, Bankën Kombëtare të Greqisë S.A, Bukuresht, Rumani, në Bankën Kombëtare të Greqisë S.A, Paris, në Phoenix Bank, Paris, etj.

Z. Canacaris është diplomuar në Universitetin e Parisit, Pantheon-Sorbonne, për Financa Evropiane dhe të Ndërmarrjeve. Ai ka një master në Ekonometri, Matematikë dhe Statistikë, si edhe një Master në Menaxhim dhe Administrim Biznesi nga "Manchester Business School".

Alexander Zsolnai - Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm

Alexander Zsolnai iu bashkua Raiffeisen Bank në mars 2010 si Anëtar Bordi për Financën dhe Riskun. Ai është emëruar Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm/Zëvendëskryetar i Bordit Drejtues që prej 1 tetorit 2010 krahas pozicionit si Drejtor Ekzekutiv për Financën dhe Riskun. Që prej muajit korrik 2015 ai është gjithashtu përgjegjës për Operacionet dhe Teknologjine e Informacionit në nivel bordi.

Z. Zsolnai ka një përvojë të gjerë bankare dhe ekzekutive. Ai mbajtur pozicionin e Anëtarit të Bordit Drejtues dhe Drejtorit Ekzekutiv për Financën dhe Riskun në Raiffeisen Bank Bosnja & Hercegovina d d Sarajevë, Drejtorit Ekzekutiv të HVB- Central Profit, Banka d.d., Sarajevë dhe Këshilltarit të Lartë për rajonin e Evropës Juglindore për krijimin e kontrollit të shitjeve rajonale, Drejtorit të Zhvillimit të Rrjetit të Degëve në rrjetin e degëve të divizionit të biznesit (organizatë e menaxhimit të përbashkët me PSK/Austrian Post Bank), etj. Z. Zsolnai është diplomuar në Universitetin e Vienës për Administrim Biznesi dhe ka disa kualifikime në zhvillimin strategjik dhe operativ të tregjeve të reja / fushat e biznesit, hartimin dhe zbatimin e proceseve të ndryshimit dhe atyre inovative, zhvillimin e kanaleve të shitjes, veçanërisht rrjetet e degëve, proceset dhe organizimin e menaxhimit të riskut, menaxhimin e njerëzve dhe organizatave, veçanërisht në një mjedis kompleks, etj.

John McNaughton - Anëtar Bordi për Biznesin Retail

Z. McNaughton iu bashkua Raiffeisen Bank në tetor 2009 si Anëtar Bordi për Biznesin Retail. Ai është përgjegjës për drejtimin e Biznesit Retail, strategjisë së tij dhe rezultateve në fitim e të ardhura, si edhe drejtimin e drejtpërdrejtë të të gjitha aspekteve të Biznesit Retail (produkteve, segmenteve, shitjeve dhe shperndarjes së rrjetit).

Me parë ai ka qenë Drejtor i Veprimtarisë Bankare për Konsumatorët, Raiffeisen Bank Aval, Ukrainë, ku ka qenë përgjegjës për drejtimin e Segmentit për Individët (strategji, planifikim, të ardhurat bruto, CM1) duke kontrolluar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha aspektet e marketingut, produkteve, cmimit, zhvillimeve me klientin dhe CRM-së për Biznesin e Individëve. Gjatë periudhës Korrik 2004-Dhjetor 2006 Z. McNaughton ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Veprimtarisë Bankare për Konsumatorët në Raiffeisen Bank Shqipëri ku ka qenë përgjegjës për drejtimin e Segmentit të Individëve, si edhe rilançimin e Biznesit të Individëve nga Banka e Kursimeve në një shërbim të plotë të veprimtarisë bankare për konsumatorët nën emrin e Raiffeisen Bank.

Përvoja të tjera drejtuese të Z. McNaughton përfshijnë Drejtor i Kartave për Biznesin, Al Rajhi Bank, Riyadh, Saudi Arabia, Zëvendës-president i Shitjeve & Marketingut Saudi Globalstar, Riyadh, Saudi Arabia, Zëvendës-president, Marketingu i Kartave Diners Club/enRoute Card (Citibank), Montreal, Canada.

Elona Mullahi (Koci) - Anëtare Bordi për Biznesin me Korporatat dhe Bizneset e Vogla (SE)

Znj. Mullahi (Koçi) është Anëtare Bordi për Biznesin me Korporatat dhe Bizneset e Vogla (SE) që prej muajit tetor 2015. Ajo ka një përvojë 13-vjecare në sistemin bankar dhe njohuri të thella në biznesin e Korporatave dhe atë të ndërmarrjeve të vogla, riskun e kredisë, si dhe funksione të tjera biznesi dhe mbështetëse në industrinë bankare.

Nga viti 2004, vit në të cilin iu bashkua Raiffesien Bank, deri në vitin 2009 Znj. Mullahi (Koçi) ka drejtuar Departamentin e Institucioneve Publike, Qeverisjes Qendrore dhe Lokale. Ndërsa që nga viti 2010, ka drejtuar segmentet e biznesit që përfshijnë korporatat vendase dhe ato ndërkombëtare, bizneset e vogla, si dhe të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale, institucione të tjera të sektorit publik, institucione financiare, (psh. institucione financiare jo-banka, kompani sigurimi, brokera si dhe kompani leasing), si dhe OJQ.

Gjithashtu, Znj. Mullahi (Koçi) ka një përvojë të gjatë dhe ka punuar në pozicione menaxheriale edhe në Bankën Amerikane të Shqipërisë, Bankën Kombëtare të Greqisë, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, Ministrinë e Financave, etj.

Elona Mullahi (Koci) mban gjithashtu pozicionin e Anëtares së Komitetit të Kredisë të Bankës. Ajo ka mbajtur gjithashtu pozicionin e Anëtares së Këshillit të Administrimit të Raiffeisen Leasing që nga viti 2010 deri në 2015, si edhe pozicionin e Anëtares së Këshillit të Administrimit të Raiffeisen Invest nga viti 2011 deri në vitin 2014.

Egon Lerchster - Anëtar Bordi për Teknologjinë e Informacionit dhe Operacionet

Egon Lerchster u bë pjesë e Raiffeisen Bank në Shqipëri në Shtator 2017 si Anëtar i Bordit për Teknologjinë e Informacionit dhe Operacionet.

Egon Lerchster filloi punën në Raiffeisen në vitin 1998 si Auditor i TI-së. Ndërmjet viteve 2000 dhe 2012, ai ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Auditimit të TI-së të Raiffeisen Zentralbank AG, duke qenë gjithashtu përgjegjës për ngritjen e funksioneve të auditimit të TI-së në nivel grupi, si edhe për zhvillimin e një programi kompjuterik të standardizuar të punës së auditimit, përfshirë edhe raportimin e standardizuar të auditimit. Në vitin 2012, Lerchster mori drejtimin e Divizionit të Kontrollit të Brendshëm të Raiffeisen Bank International AG, ku ndër të tjera ishte përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të auditit përkundrejt Bordit të Menaxhimit, Këshillit Drejtues, Bankës Qendrore Evropiane dhe auditorëve të jashtëm.

Egon Lerchster zotëron një diplomë në Shkencat Sociale dhe Ekonomike (Mag. rer.soc.oec) nga Universiteti i Ekonomisë dhe Biznesit në Vjenë. Gjatë angazhimit të tij për më shumë se 20 vjet në Raiffeisen, ai ka plotësuar ekspertizën e tij me disa certifikata shtesë në menaxhimin e projekteve, si edhe menaxhimin dhe riprojektimin e proceseve.